



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURES
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 1384 Prot.

Tiranë, më 24.10 2018

VENDIM Nr. 221, datë 17.10.2018

Në mbështetje të *Ligjit Nr. 27/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë"*, Neni 48, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr. 10, datë 17.10.2018, pasi shqyrtoi Raportin e sondazheve arkeologjike në kuadër të projektit "*Teleferiku Krujë-Mali Krujë (Sari-Salltik)*" në Zonë arkeologjike "B" - subjekti "URBAN TRANS" sh.p.k., realizuar nga subjekti "AD – STAR" sh.p.k.,

VENDOSI:

1. Të miratojë Raportin e sondazheve arkeologjike në kuadër të projektit "*Teleferiku Krujë-Mali Krujë (Sari-Salltik)*" në Zonë arkeologjike "B" - subjekti "URBAN TRANS" sh.p.k., realizuar nga subjekti "AD – STAR" sh.p.k.
2. Subjekti "URBAN TRANS" sh.p.k., të vijojë procedurën e shqyrtimit dhe vendimmarrjes në organet përkatëse të qeverisjes vendore.
3. Pas paisjes me lejen përkatëse të lëshuar nga organet e qeverisjes vendore, punimet e gërmimit do të realizohet nën monitorimin ditor të subjektit të licencuar në arkeologji, në vijim të akt-marrëveshjes tre palëshe të lidhur më parë për këtë objekt.
4. Investitori duhet të derdhë detyrimet tatimore për mbikëqyrjen e realizuar nga ASHA, sipas tarifave të miratuara me Urdhërin e Ministrit Nr. 384, datë 21.10.2015 dhe përcaktimeve përkatëse të akt-marrëveshjes tre palëshe.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë

Tel: ++355 04 45 35 855

email: sekretaria.kka@asha.gov.al

Website: asha.gov.al

